

POLITIKA E PRIVATËSISË - KLIENTËT DHE PARTNERËT

Ky informacion ofrohet në përputhje me nenin 13 të ligjit 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" për personat që preken nga përpunimi i të dhënave të tyre personale sipas marrëdhënies së furnizimit dhe/ose bashkëpunimit që ekziston me ta.

Ky dokument ju shpjegon qëllimet dhe metodat me të cilat përpunohen të dhënat tuaja personale, të dhënat personale që përpunohen, të drejtat që kanë subjektet e të dhënave dhe si mund të ushtrohen këto të drejta.

1. Kontrolluesi i të Dhënave dhe Zyrtari për Mbrojtjen e të Dhënave

Kontrolluesi i të dhënave tuaja personale të përmendura në këtë njoftim është shoqëria Engineering Albania Shpk me të cilën ju ose shoqëria juaj keni marrëdhënie kontraktuale ("**Kontrolluesi i të Dhënave**").

Kontrolluesi i të Dhënave ka caktuar një *Nepunes për Mbrojtjen e të Dhënave* ose "**DPO**", që mund të kontaktohet në adresën e mëposhtme të email-it: elona.mekshi@eng.it

2. Kategoritë e të dhënave personale të përpunuara

Kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhënat personale të një natyre të përbashkët që lidhen drejtpërdrejt me klientin/partnerin ose me personat e përfshirë në strukturën e klientit/partnerit, siç janë bashkëpunëtorët, punonjësit dhe/ose referentët e klientit/partnerit. Në rast se të dhënat personale të bashkëpunëtorëve/punonjësve/referentëve të klientit/partnerit i komunikohen Kontrolluesit nga klienti/partneri, atëherë klienti/partneri angazhohet t'ua kalojë këtë informacion personave të cilëve u komunikon të dhënat personale.

Të dhënat e mbledhura dhe të përpunuara janë të dhëna personale dhe të identifikimit, të kontaktit (numri i telefonit, adresa e email-it) dhe financiare të personave të përfshirë në kapacitetin e tyre si persona kontakti për zbatimin e marrëdhënieve të furnizimit dhe/ose bashkëpunimit, në masën që këto të dhëna janë të nevojshme për zbatimin e duhur të marrëdhënieve të përmendura më lart ose ofrohen vullnetarisht nga personi i përfshirë.

3. Qëllimi i përpunimit dhe baza ligjore

Kontrolluesi i të Dhënave do të përpunojë të dhënat tuaja për zbatimin e kontratave të furnizimit/partneritetit, për menaxhimin e brendshëm të klientëve/partnerëve, si dhe për qëllimin e përmbushjes së detyrimeve ligjore që i përkasin Kontrolluesit të të Dhënave.

Veçanërisht, të dhënat tuaja personale do të përpunohen:

- a. për qëllimet e **përmbushjes së kontratës** në të cilën subjekti i të dhënave është palë ose për zbatimin e masave kontraktuale paraprake të marra sipas kërkesës së subjektit të të dhënave;
- b. për **të përmbushur detyrimet ligjore** që i ngarkohen Kontrolluesit të të Dhënave;
- c. për verifikime të besueshmërisë kreditore për të mbrojtur interesat ekonomike dhe të

reputacionit të shoqërisë

- d. për verifikimet lidhur me kërkesat e nevojshme për të marrë pjesë në tendera publikë, nëse ka një marrëveshje partneriteti ose nënkontraktimi ndërmjet jush dhe Kontrolluesit të të Dhënave
- e. për qëllime të komunikimit dhe menaxhimit të ngjarjeve të synuara dhe/ose të propozuara nga Kontrolluesi (p.sh. dërgimi i komunikimeve lidhur me ngjarjet, publikimi i informacionit), duke vepruar sipas **interesit të ligjshëm** të Kontrolluesit për të siguruar menaxhimin efektiv të ngjarjeve dhe komunikimin efektiv me klientët/partnerët e vet;
- f. për përcaktimin, kryerjen e auditimeve të sigurisë së të dhënave dhe rrjetit dhe parandalimin dhe luftimin e krimeve të mundshme kibernetike, duke vepruar sipas **interesit të ligjshëm** të Kontrolluesit për të ruajtur mbrojtjen e sistemeve të brendshme të IT-së dhe për të zbatuar masat e nevojshme të sigurisë, si dhe për të kërkuar, ushtruar ose mbrojtur një të drejtë në gjykatë
- g. për të kryer sondazhe të vlerësimit së klientëve, analiza statistikore dhe shërbime të lidhura, duke vepruar sipas **interesit të ligjshëm** të Kontrolluesit për të siguruar mundësinë e kryerjes dhe përmirësimit të biznesit të vet.
- h. për të dërguar komunikime tregtare dhe/ose promovuese të subjekti i të dhënave lidhur me produktet dhe/ose shërbimet e ofruara nga Kontrolluesi i të Dhënave. Baza ligjore për përpunimin e të dhënave të përcaktuara në këtë pikë është miratimi specifik i shprehur nga subjekti i të dhënave sipas ;
- i. për të dërguar komunikime tregtare dhe/ose promovuese të subjekti i të dhënave lidhur me produktet dhe/ose shërbimet nga shoqëri të tjera të Grupit Engineering. Baza ligjore për përpunimin e të dhënave të përcaktuara në këtë pikë është miratimi specifik i shprehur nga subjekti i të dhënave sipas ;
- j. për kryerjen e analizave të tregut dhe kërtimeve të kryera nga Kontrolluesi i të Dhënave ose partnerët e vet. Baza ligjore për përpunimin e të dhënave të përcaktuara në këtë pikë është miratimi specifik i shprehur nga subjekti i të dhënave sipas ;
- k. për dërgimin e komunikimeve tregtare dhe/ose promovuese nëpërmjet email-it lidhur me produkte ose shërbime të ngjashme me ato që janë blerë tashmë (të ashtuquajturat "email marketingu"). Ju gëzoni gjithmonë të drejtën të ndaloni dërgimin e këtyre komunikimeve duke shkruar në adresat e treguara në këtë njoftim. Baza ligjore për dërgimin e email-eve të marketingut është sipas interesit të ligjshëm të Kontrolluesit të të Dhënave për të reklamuar produkte ose shërbime të ngjashme me ato që janë blerë tashmë.

Çdo miratim i dhënë mund të revokohet në çdo kohë, duke ndërprerë kështu kryerjen e aktiviteteve tregtare dhe promovuese të përmendura më lart, duke shkruar në adresat e treguara në këtë njoftim.

4. Përpunuesit e të Dhënave dhe Personat e Autorizuar

Kontrolluesi i të Dhënave do të ndajë të dhënat tuaja personale me punonjësit dhe bashkëpunëtorët e tij, të cilët janë identifikuar dhe udhëzuar posaçërisht me akt të shkruar, sipas ligjit 124/2024. Këta individë do t'i përpunojnë të dhënat nën

mbikeqyrjen e Kontrolluesit të të Dhënave, vetëm për qëllimin e përcaktuar me sipër.

Të dhënat tuaja personale mund të ndahen gjithashtu me palë të treta, të cilat janë emëruar me shkrim nga Kontrolluesi i të Dhënave në përputhje me ligjin 124/2024, ose, kur kërkohet nga legjislacioni në fuqi, si kontrollues të pavarur të të dhënave.

Lidhur me këto kategori marrësish nga palë të treta, specifikohet se të dhënat tuaja mund të ndahen me:

- organe dhe autoritete publike kur kërkohet nga ligji ose me urdhër të autoriteteve kompetente;
- Engineering Group;
- persona fizikë ose juridikë, shoqata që ofrojnë shërbime dhe aktivitete konsulence dhe ndihme për Kontrolluesin e të Dhënave;
- partnerë biznesi që mbështesin Kontrolluesin e të Dhënave për zbatimin dhe menaxhimin e qëllimeve të përcaktuara;
- bankat, institucionet financiare dhe shoqëritë e sigurimeve.

5. Transferimi i të dhënave

Në zbatim të qëllimeve të mësipërme, disa nga të dhënat tuaja personale mund të shperndahen me marrës të vendosur jashtë Bashkimit Evropian ose Zonës Ekonomike Evropiane (BE/EEA).

Në raste të tilla, Kontrolluesi i të Dhënave siguron që transferimi i të dhënave të realizohet në përputhje me dispozitat e Kapitullit IV të ligjit 124/2024.

6. Afatet e Ruajtjes së të Dhënave

Të dhënat tuaja personale do të ruhen duke respektuar plotësisht sigurinë dhe qëndrueshmërinë e sistemeve të përdorura për përpunimin e tyre, për aq kohë sa është e nevojshme për të arritur qëllimet për të cilat janë mbledhur. Veçanësisht, ruajtja dhe përpunimi i të dhënave tuaja do të kryhet në përputhje të plotë me parimet e minimizimit të të dhënave dhe kufizimit të ruajtjes..

Për më tepër, Kontrolluesi mund t'i mbajë të dhënat tuaja personale për një afat më të gjatë, kur kjo është e nevojshme për të përmbushur detyrimet kontraktuale dhe ligjore që e detyrojnë, ose për të kërkuar, ushtruar apo mbrojtur të drejtat e tij ligjore brenda apo jashtë gjykatës, gjithmonë brenda afateve maksimale të lejuara *nga ligji në fuqi*.

7. Të drejtat e Subjekteve të të Dhënave

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, ju gëzoni të drejtat e mëposhtme:

- **Aksesi:** ju gëzoni të drejtën të hyni në çdo kohë në të dhënat lidhur me ju dhe që janë të disponueshme për Kontrolluesin e të Dhënave, si dhe në çdo informacion të nevojshëm në lidhje me përpunimin e tyre;
- **Korrigjimi:** ju keni të drejtë të kërkonti dhe të merrni korrigjimin dhe/ose përditësimin e çdo të dhëne të pasaktë që lidhet me ju dhe që mbahet nga Kontrolluesi i të Dhënave;
- **Fshirja:** në rrethana të veçanta, ju keni të drejtë të kërkonti dhe të merrni, pa vonesë të panevojshme, fshirjen e të dhënave tuaja personale në posedim të Kontrolluesit të të Dhënave;
- **Kufizimi:** në raste të caktuara, ju keni të drejtë të kufizoni përpunimin e të dhënave tuaja;
- **Transportueshmëria:** në rast të përpunimit automatik të të dhënave bazuar në miratimin tuaj ose në përmbushjen e një kontrate, ju keni të drejtë të merrni të dhënat tuaja personale të dhëna Kontrolluesit të të Dhënave në një format të strukturuar, të përdorur zakonisht dhe të lexueshëm nga makina, si dhe t'i transmetoni ato te një kontrollues tjetër pa pengesë;
- **Kundërshtimi:** ju keni të drejtë të kundërshtoni në çdo kohë, për arsye që lidhen me situatën tuaj të veçantë, përpunimin e të dhënave tuaja personale të bazuar në ndjekjen e interesave legjitime të Kontrolluesit, përveç rasteve kur ai provon ekzistencën e bazave ligjore bindëse që mbizotërojnë interesat, të drejtat dhe liritë tuaja;
- **Vendimarrja e automatizuar:** ju keni të drejtë të mos i nënshtroheni një vendimi të bazuar vetëm në përpunimin e automatizuar të të dhënave tuaja, përfshirë profilizimin, kur një vendim i tillë mund të ketë ndikim të rëndësishëm mbi ju.

Ju mund t'i ushtroni këto të drejta, në përputhje me Nenet 14-20 të ligjit 124/2024 duke kontaktuar Kontrolluesin e të Dhënave në adresën e përcaktuar në këtë njoftim ose duke shkruar te DPO-ja në adresën: elona.mekshi@eng.it

Pa paragjykuar ndonjë mjet tjetër juridik administrativ ose gjyqësor, juve ju jepet gjithashtu e drejta për të paraqitur ankesën pranë Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale nëse vlerësoni se të drejtat tuaja për mbrojtjen e të dhënave janë shkelur. Për më tepër informacion është i disponueshëm në faqen e internetit <https://idp.al/> dhe <https://idp.al/kontakt/>